# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449118**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Berisha: Vizita ime në SHBA duhet të shërbejë si një apel bashkimi për të gjithë demokratët |
| ADRESA | `https://dosja.al/politike/berisha-vizita-ime-ne-shba-duhet-te-sherbeje-si-nje-apel-bashkimi-per-t-i514447` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 12:20:50 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 12:17:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c3de34fe597db5387bab1d67050f0c051203a67a9d7453f2adf25f93734d00b7` |
| TEKSTI | `8414d54c9f7a258fa41bb05b8333c3857ef91dc1a9ba247ba285fb2d338d2401` |
| PAMJA | `c35c81009e498b6f27a7bbbc668f5fa1cbae066519c70b58094b37a398bd46bf` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `23a25402ed4e17d102d20763d62b115dcc699ad79f7d2caee2f6d39974d6b570` |
| E MËPARSHMJA | `f188363af15e5fd5c5f4f8adb2ddea9be64e930a36e4559c64db1ac88aca7ad1` |
| RRËNJA MERKLE | `485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/23a25402ed4e17d102d20763d62b115dcc699ad79f7d2caee2f6d39974d6b570`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Politike

# Berisha: Vizita ime në SHBA duhet të shërbejë si një apel bashkimi për të gjithë demokratët

Gjatë mbledhjes së grupit parlamentar, Berisha e lidhi këtë apel edhe me udhëtimin e tij të fundit në SHBA, duke u shprehur se ai duhet të shërbejë si një mundësi për të kapërcyer edhe rezervat e atyre që e kanë konsideruar çështjen e vizës së tij si pengesë për rikthimin në parti.

16 Shtator 2026, 14:17
Nga I.A




Sali Berisha

**TIRANË-** Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka bërë thirrje për bashkim brenda opozitës, duke u drejtuar veçanërisht demokratëve që janë distancuar nga PD-ja për shkak të mospajtimeve politike. Gjatë mbledhjes së grupit parlamentar, Berisha e lidhi këtë apel edhe me udhëtimin e tij të fundit në SHBA, duke u shprehur se ai duhet të shërbejë si një mundësi për të kapërcyer edhe rezervat e atyre që e kanë konsideruar çështjen e vizës së tij si pengesë për rikthimin në parti.

Ai theksoi se ftesa nuk u drejtohet personave që, sipas tij, kanë interesa të lidhura me qeverinë, por demokratëve që janë larguar për shkak të bindjeve apo mospajtimeve me drejtimin e PD-së. Sipas Berishës, momenti aktual duhet të shërbejë për një rikthim të tyre në strukturat e opozitës.

*"Zonja dhe zotërinj, siç jeni informuar, javën e kaluar ne, me një grup drejtuesish të PD, morëm pjesë në konventën e Partisë Republikane të zgjedhjeve afatmesme, i ftuar nga IDU për të marrë pjesë në këtë konferencë së bashku me zotin Fatmir Mediu, kryetar i Partisë Republikane, anëtar i IDU si parti, njëlloj si ne. Vetëkuptohet, pavarësisht nga komentet, kjo nuk ishte një vizitë personale, nuk ishte një udhëtim personal, nuk kishte asgjë personale në këtë udhëtim.*

*Ishte në respektim të një ftese dhe pjesëmarrje në aktivitetin më kryesor të partisë në pushtet, Partisë Republikane. Para se të shkojmë aty, ne patëm një takim të shkëlqyer me diasporën dhe shpreh një mirënjohje të pakufishme ndaj tyre për pritjen që na organizuan, pritjen vëllazërore, angazhimin, mbështetjen e jashtëzakonshme. Në konventë, faktikisht Dallasi ishte kthyer në kryeqytetin politik, të themi, të SHBA ato ditë. Ndaj dhe ne patëm rast të*

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 12:46
DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:40
"Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë u prit në lot nga qytetarët"/ Reuters: Vendimi u ndoq nga afër edhe Serbi

*bëjmë takime me personalitete të shquara, si të Kongresit të SHBA, por edhe të administratës së presidentit Trump. Në të gjitha këto takime, ne kemi paraqitur realitetin shqiptar sipas mendimit tonë.*

*Dhe, jemi ndalur në dy çështje më themelore, narkoshtetin dhe farsën zgjedhore. Mendoj se kemi gjetur mirëkuptim real me bashkëbiseduesit tanë. Siç është faktuar dhe në qëndrimin e Sekretarit Rubio ndaj zgjedhjeve në Shqipëri, që nuk dërgoi mesazh urimi, sepse sipas zëdhënësit të DASH, ai uron vetëm zgjedhjet e lira, pra e qartë që administrata njihte zhvillimet në procesin zgjedhor, dorën e zezë, siç e shprehu dje kryetari i komisionit të Helsinkit në Kongresin e SHBA, Joe Wilson që tha se janë përdorur nga Edi Rama, organizatat kriminale, faktorë të tjerë për të ndërhyrë në zgjedhjet. Dhe, mendoj se këto takime ishin shumë të dobishme dhe shënojnë konsolidimin e një dialogu intensiv të PD me SHBA, bashkëpunimin me këtë vend të madh.*

*Por nga ana tjetër duhet të them këtu se ky udhëtim i imi duhet, dhe shpresoj të shërbejë, edhe si një apel bashkimi për të gjithë ata demokratë dhe demokrate, që gjer sot kanë konsideruar ndalimin e vizës për Sali Berishën si një pengesë për t'u bashkuar me ne. Unë i ftoj ata të kthehen te kontributet e tyre. Ata janë njerëz që kanë kontribuar. Nuk e kam fjalën për aksionerët, bashkëaksionerët me qeverinë, se ata nuk vijnë edhe po t'u them unë edhe 100 herë, ata nuk i lënë aksionet e tyre. Por e kam fjalën për shumë të tjerë, të cilët për mendimin e tyre janë distancuar nga partia, nga udhëheqja e saj, etj me radhë. Është një moment që t'i ftoj me shumë sinqeritet, me shumë përzemërsi, dhe u ftoj ju të gjithëve që këtë qëndrim të mbajmë në mënyrë që këta zonja, zotërinj, që janë opozitarë, që qëndrojnë opozitarë, të rikthehen tek investimi i tyre, tek partia e tyre,"* tha Berisha.**/Dosja.al**

sali berisha

## Sondazh

Poll

Politike

16 Shtator 2026, 14:11

# Çfarë ndodhi gjatë takimit? Rama përplaset edhe në Korçë me qytetarët, banorët e Maliqit: Mos na e shkrini bashkinë!

Edi Rama KORÇË- Kryeministri Edi Rama është përballur me kundërshtime nga qytetarët e Maliqit gjatë diskutimeve p...

VIDEO/ Haga e dënoi me 25 vite burg, ja si e priti Hashim Thaçi vendimin

Politike

16 Shtator 2026, 13:57

"PD hesen se apeli do bëjë drejtësi"/

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:09

"Nuk do të na thyejë"/ Vajza e Jakup Krasniqit reagon pas dënimit me 25 vjet: Padrejtësia më e madhe e këtij shekulli

## më të klikuarat

**Rishfaqet "diMAL", pas mishit të infektuar, drogë në kontejner**

**Daja i saj përdhunoi 34-vjeçaren, reagon Zegjine Çaushi: Më thanë se do martohen**

**Kongresmeni Wilson: Qeveria e Ramës po nxit trafikun e narkotikëve. Zv/ndihmës Sekretari Lawton: Organizatat kriminale kanë lidhje me kartelet këtu në SHBA**

**"Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ The New Yorker: Si u hapën dyert për Jared Kushner**

## insights

Auron Janku

**Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë**

Ola Xama

**Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen**

Idriz Konjari

**Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?**

Bledian Koka

**Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?**

## Moti

Powered by tomorrow.io

"PD beson se apeli do bëjë drejtësi"/ Berisha: Gjykata justifikoi akuzat bajate të padronit të Edi Ramës

Politike

16 Shtator 2026, 13:57

---

Haga dënoi Kosovën/ Daçiç: Aktgjykimi "konfirmon" pretendimet e Serbisë për UÇK-në

Politike

16 Shtator 2026, 13:51

---

"Asgjë nuk mund të errësojë luftën çlirimtare të popullit të Kosovës"/ Berisha: Vendimi për ish-drejtuesit e UÇK-së ishte i padrejtë dhe i pamerituar

Politike

16 Shtator 2026, 13:44

---

Politike

16 Shtator 2026, 13:36

## Protestat në Hagë dhe Prishtinë/ BE-ja bën thirrje për përmbajtje pas vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Foto ilustruse BRUKSEL- Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje të gjitha palëve dhe aktorëve në Kosovë dhe në...

---

Ali Ahmeti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së: Procesi nuk përfundon këtu, beteja do të vazhdojë në Gjykatën e Apelit

Politike

16 Shtator 2026, 13:34

---

Abdixhiku: UÇK-ja mbetet pjesa më krenare e historisë së popullit tonë

Politike

16 Shtator 2026, 13:20

### Osmani reagon pas vendimit në Hagë: UÇK-ja, pjesa më krenare e historisë

Politike

16 Shtator 2026, 13:17

### Avokati i Thaçit paralajmëron apelimin e vendimit: Ditë e errët për drejtësinë ndërkombëtare

Politike

16 Shtator 2026, 12:59

**MË SHUMË**






Pamje prekëse nga Prishtina/ Polici shpërthen në lot kur protestuesit i vendosin pranë flamurin



Haga dënon ish krerët e UÇK-së me 81 vite burg, vogëlushi shpërthen në lot



Haga e dënoi me 25 vite burg, ja si e priti Hashim Thaçi vendimin



Haga dënon ish- krerët e UÇK-së me 81 vite burg, shqiptarët përplasen me policinë pas vendimit

## Pamje prekëse nga Prishtina/ Polici shpërthen në lot kur protestuesit i vendosin pranë flamurin

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

AKTUALITET
POLITIKE
EKONOMI
BOTA
SPORT
ART&ARGËTIM
INSIGHTS
EDITORIAL

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDESUAR NGA Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.